

armatimesh matanë kufirit me Kosovën. Në bjeshkën e **Pashtrikut/Paştrik** kanë rënë në pritën e kufitarëve serb. Dinin e kanë qëlluar për vdekje, ndërkaq të tjerë u tërhoqën në Shqipëri. Trupi i Dinit është gjetur pas lufte në fshatin Brekoc/Brekovac [Gjakovë/Đakovica]. I vëllai e ka njohur në bazë të orës së dorës. E kanë varrosur më 5.07.1999 në varrezat e fshatit Kishaj, në Shqipëri.

Burimet: deklarata A.K, FDH-40596; J. Osmani, *Krimet...*, II, 467.

Besim (Muhamed) Drenica

(20.02.1971, shqiptar nga Borja [Shqipëri])

Në datën **4.06.1998**, rreth orës 3:00, Besimi, së bashku me dy persona të pidentifikuar, tentoi që të kalonte kufirin nga Shqipëria në Kosovë, në rajonin e postbllokut ushtarak **Çestak/Čestak**. Pjesëtarët e UJ-së kanë shtënë drejt tyre. Besimi ka gjetur vdekjen gjatë shkëmbimit të zjarrit. Persona, që ishin në shoqërinë e tij, kanë arritur të iknin me vrap. Pas kryerjes së hetimit në vendngjarje, trupin e Besimit e kanë marrë pjesëtarët e Shërbimit Kufitar të Shqipërisë.

Burimi: ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D.300.46, FDH-32380.

Hysni (Hajriz) Jetullahu

(8.04.1954, shqiptar nga Domaneku/Domanek, komuna e Gllgocit/Glogovac, pedagog, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hysniu ka punuar në stacionin hekurudhor në Bajicë/Banjica [Gllgoc/Glogovac] deri në vitin 1990. Po atë vit, u pushua nga puna. U bë anëtar i UÇK-së në muajin prill të vitit 1998. Në fillim të qershorit të vitit 1998, ka shkuar në Shqipëri për një ngarkesë armatimesh. Në datën **11.06.1998**, së bashku me disa bashkëluftëtarë, u nis për në Kosovë. Në bjeshkën e **Pashtrikut/Paştrik**, kanë rënë në pusi të forcave serbe. Hysniu gjeti vdekjen gjatë shkëmbimit të zjarrit. Po atë ditë, bashkëluftëtarët e kanë varrosur atë afër vendit ku e humbi jetën. Pas lufte, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në varrezat e fshatit të tij të lindjes së Domanekut/Domanek.

Burimet: SHFDUÇK, *Feniksët...*6, 169-171; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Ylber (Zenel) Fanaj

(29.08.1979, shqiptar nga Vërnica/Vrbnica, komuna e Prizrenit/Prizren, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Albrim (Zaim) Fanaj

(28.08.1978, shqiptar nga Vërnica/Vrbnica, komuna e Prizrenit/Prizren, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Ylberi me djalin e axhës Albrimin kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Në fund të muajit prill të vitit 1998, kanë shkuar në Shqipëri për trajnim ushtarak, ndërkaq në datën **10.07.1998**, Ylberi, Albrimi dhe disa pjesëtarë të tjerë të UÇK-së u nisën për në Kosovë. Në afërsi të **Vërnicsë/Vrbnica**, hasën në kufitarët e postbllokut të afërt ushtarak dhe mes tyre shpërtheu përleshja e armatosur. Ylberi dhe Albrimi kanë rënë në këtë betejë. Ushtarët serb i kanë bartur trupat e tyre në morgun e spitalit të Prizrenit/Prizren. Në datën 12.07.1998, familjarët i kanë marrë trupat e Ylberit dhe Albrimit. I kanë varrosur në varrezat e fshatit të lindjes së Vërnicsë/Vrbnica. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur [15.09.1999] në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Landovicë/Landovica, komuna e Prizrenit/Prizren.

Burimet: deklarata S.F, FDH-8611; deklarata Z.F, FDH-20906; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D300.77, FDH-30565; *Serb Army Kills Two Albanians in Kosova-Albanian Border*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.07.1998, FDH-2935; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Teki (Selami) Ramsha

(28.05.1973, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, vullkanizor, një fëmijë)

Teki jetonte me bashkëshorten Nashiden dhe djalin Albertin, tre vjeç. E kishte punëtorinë për shërbime të vullkanizimit në qytet. Për nevojat e UÇK-së, i mblidhte kontributet financiare nga pronarët e dyqaneve në qytet, ndërkaq natën i riparonte makinat e UÇK-së. Kur forcat serbe, më **19.07.1998**, e rikthyen kontrollin mbi